



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2023:252068
Datë: 03.12.2024
Numri i dokumentit: 06542638

K.DH.SH.II.nr.1645/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit KRM “Eko Regjioni” Sh.A., me numër të biznesit 70465066 dhe me seli në Rahovec, Njësia Operative, kundër debitorit N.P.T “Visari”, me numër unik identifikues 810388240 dhe seli në Rahovec, rr. “Xhelal Hajda Toni”, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti i për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1916/23 të datës 04.06.2024, me datë 27.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e kreditorit KRM “Eko Regjioni” Sh.A., me seli në Rahovec, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr. 1916/23 të datës 04.06.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 1916/23 të datës 04.06.2024, e ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit N.P.T “Visari me seli në Rahovec dhe ka anuluar Urdhrin Përmbarimor P.nr.719/23 të datës 03.11.2023, të lejuar nga Përmbaruesi Gjokë Radi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori KRM “Eko Regjioni” Sh.A., me seli në Rahovec, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës civile dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që të aprovohet ankesa e kreditorit në tërësi si e bazuar, ndërsa aktvendimi i kundërshtuar të priset dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje ose ta ndryshoj aktvendimin e atakuar.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit

nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori KRM “Eko Regjioni” Sh.A me seli në Rahovec, me datën 03.11.2023 ka paraqitur propozim për përmbartim, kundër debitorit N.P.T “Visari”, me seli në Rahovec, në bazë të dokumentit të besueshëm – Ekstraktit nga librat e Kontabilitetit me shifër L0041513, në shumë të përgjithshme prej 309.92 €.

Përmbartuesi Gjokë Radi, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit KRM “Eko Regjioni” Sh.A me seli në Rahovec, ka caktuar urdhrin P.nr. 719/23 të datës 03.11.2023 duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm, Ekstraktit nga librat e Kontabilitetit, me shifër L0041513, me të cilin ka obliguar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrin, t’ia paguaj kreditorit borxhin prej 309.92 EUR, me kamatë ligjore prej 8 %, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi për përmbartim. Debitori, brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin për lejimin e përmbartimit me arsyetim se në mes të kreditorit dhe debitorit nuk është nënshkruar kontrata për shërbime, andaj edhe borxhi i kërkuar përmes propozimit për përmbartim është pa bazë ligjore. Ka shtuar se është parashkruar kërkesa, duke qenë se vlen afati 1 vjeçar i parashkrimit, sipas nenit 360 të LMD-së. Duke qenë se dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbartimor nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa propozimi për përmbartim të hedhet si i pa bazuar. Kreditori në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit, duke theksuar se prapësimin e ka paraqitur duke mos u bazuar në asnjërën nga shkaqet për të cilat mund të paraqitet prapësimi. Ka shtuar se urdhri përmbartimor është lejuar duke u bazuar në dokument të besueshëm, andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.. Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 1916/23 të datës 04.06.2024, e ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit N.P.T “Visari me seli në Rahovec dhe ka shfuqizuar Urdhrin Përmbartimor P.nr.719/23 të datës 03.11.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Gjokë Radi.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se gjykata gjen se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përmbartimit është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase në propozim për përmbartim nuk janë paraqitur të dhënat e nevojshme për identifikimin e debitorit, dhe rrjedhimisht propozimi për përmbartim përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat tani nuk mund të evitohen, ngase gjykata në fazën e procedurës sipas mjetit juridik, kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrin. Andaj, duke qenë se urdhri përmbartimor është nxjerr pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke anuluar urdhrin përmbartimor. Tutje është theksuar se Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - Ekstrakti nga Librat e Kontabilitetit me shifër L0041513 , në bazë të së cilit është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore

për të qenë dokument i pranueshëm, për faktin se në rastin konkret nuk përmban në mënyrë të qartë të dhënat e nevojshme për përmbardim, respektivisht periudhën kohore. Ne propozim kreditori ka kërkuar borxhin ndaj debitorit ne vlerë prej 309.92 euro, ndërsa nga ekstrakti afarist i bashkëngjitur, rezulton shuma prej 1,067.36 EUR me të cilën kreditori ka kërkuar realizimin e borxhit nga muaji tetor 2018 e deri në muajin shtator 2023 mirëpo nga librat afarist përmban përmbledhjen e faturave vetëm nga data 01.01.2019. Në ndërlidhje me këtë, në ekstraktin e lartcekur, si borxh i bartur figuron shuma prej 1,067.36 EUR me ç' rast nuk dihet se për cilat shërbime dhe për cilën periudhë kohore është grumbulluar borxhi në fjalë.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të Gjykatës së Shkallës së Parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkalles së Dytë, vlerëson se Gjykata e Shkallës së Parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbardimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimit të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar - Ekstrakti nga Librat e Kontabilitetit me shifër L0041513 në bazë të së cilit është lejuar propozimi për përmbardim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i pranueshëm, për faktin se në rastin konkret nuk përmban në mënyrë të qartë të dhënat e nevojshme për përmbardim, respektivisht periudhën kohore. Nga ekstrakti afarist i bashkëngjitur, rezulton se borxhi, është kërkuar për periudhën kohore nga muaji tetor 2018 deri ne muajin shtator 2023, ndërsa në përmbajtja e këtij ekstrakti, përmban përmbledhje ne faturave vetëm nga data 01.01.2019, lidhur me këtë ne ekstraktin e lartcekur si borxh i bartur figuron shume prej 1,067.36e qe kjo lartësi nuk dihet se për cilat shërbime dhe për cilën periudhë kohore është grumbulluar borxhi në fjalë.

Nisur nga kjo gjendje faktike, kjo Gjykatë vlerëson se Dhomat e Shkallës së Parë kanë konstatuar drejtë se Ekstrakti nga Librat e Kontabilitetit me shifër L0041513 si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbardimore, respektivisht është lejuar përmbardimi nuk i plotëson kushtet në mënyrë komulative qe duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret është edhe qëndrim i kësaj gjykate se qartë rezulton nga ky ekstrakt nuk dihet se për cilat shërbime dhe për cilën periudhe kohore është grumbulluar borxhi në fjalë.

Rrjedhimisht, kjo gjykatë vlerëson se nisur nga fakti se procedura përmbardimore paraqet procedurë formale që i nënshtrohet shqyrtimit formal të dokumenteve përmbardimore dhe/apo atyre të besueshme, rrjedh se si kusht esencial mbi bazën e së cilës mund të lejohet përmbardimi janë tiparet e përmbardueshmërisë së dokumentit të besueshëm e të cilit në rastin konkret i mungojnë kushtet nga Neni 29 par.3 dhe 37 i LPP-së. Së këndejmi, Gjykata thekson se pa plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm nuk mund ta ketë fuqinë e titullit përmbardues

sepse rezulton se debitori nuk e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbarimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmbarimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e shkallës së dytë
K.Dh.Sh.II.nr.1645/24 dt.02.12.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi